



## KËSHILLË

EULEX Komponenti i Drejtësisë

Prishtinë, 23 tetor 2008

---

**Për:** Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**Kopje:**

**Nga:** EULEX Komponenti i Drejtësisë

**Lënda:** Këshillë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në lidhje me caktimin e lëndëve në Gjykatat e Kosovës

---

### 1. Përmbledhje Ekzekutive

Siç parashihet me nenin 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë, ai ka për detyrë të *“(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente në Kosovë në të gjitha fushat lidhur me sundimin më të gjerë të ligjit (duke përfshirë shërbimin doganor), ndërsa mbanë përgjegjësi të caktuara ekzekutive”*.

Neni 2.4 i Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i 13 Marsit 2008 (Ligji nr. 03/L-053) parashikon që: “përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX KOSOVË.”

Në veçanti, këshillimi përbëhet nga pozitat formale dhe zyrtare të arritura bashkërisht nga gjykatësit e EULEX-it në Asamblenë e Gjykatësve të EULEX-it dhe që i drejtohen autoriteteve vendore gjyqësore, legislative ose qeveritare për të stimuluar veprimet e tyre në fushat përkatëse të kompetencave. Me fjalë tjera, këshillimi ka për qëllim që të i jep këshilla profesionale autoriteteve kompetente (MD, KGJK, IGJK, Kryetarët e Gjykatave, Gjykata Supreme, Parlamenti, Fakultetet Juridike) mbi secilën temë që ngritet nga përvojat e monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi pajisë palët e interesuara kosovare me informata të nevojshme për të intervenuar në ato fusha të sistemit gjyqësor ku ekziston nevoja për implementimin e përmirësimeve të përgjithshme dhe strukturore për tërë sistemin gjyqësor dhe

#### EULEX Kosovë

Rr. Mbreteresha Teuta 21,  
Tauk Bahçe,  
Rruga për Germi,  
Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +(381) 38 51 39 300  
Fax: +(381) 38 51 39 333  
www.eulex-kosovo.eu,  
info@eulex-kosovo.eu



kjo nuk mund të bëhet vetëm me anë të aktivitetit të udhëzimit nga gjykatësit e EULEX-it.

Këshilla e tanishme drejtuar KGJK-së mbi sistemin e caktimit të lëndëve është rezultat i aktiviteteve të monitorimit dhe udhëzimit të gjykatësve të EULEX-it, në konsultim të ngushtë me homologët e tyre kosovarë. Në veçanti, gjetjet e këtyre aktiviteteve demonstrojnë nevojën urgjente për të adoptuar udhëzime për një sistem të drejtë dhe transparent të caktimit të lëndëve në të gjitha Gjykatat e Kosovës.

## 2. Hyrje

“E drejta për një proces të rregullt” është një princip i pranuar në tërë Evropën (neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore KEDNJ), që do të thotë që “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazat e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij.”

“E krijuar ligjërisht” do të thotë jo vetëm që autoriteti sovran i një shteti ka vendosur që të zgjedh një gjykatë në një rajon të caktuar dhe për një juridiksion të caktuar por gjithashtu që është emëruar një gjykatës i vetëm i asaj gjykatë dhe që ai kryen detyrat e tij në pajtim me dispozitat e përgjithshme të përcaktuara paraprakisht nga ligji.

Në pajtim me këtë princip shtetet evropiane kanë adoptuar rregulla të përgjithshme për caktimin e lëndëve, të zbatuara çdo vit me vendimet e Gjyqësorit. Ligji dhe urdhëresat vendosin paraprakisht kriteret sipas të cilave caktohet një gjykatës i vetëm, i cili është “gjykatësi natyral ligjor” për një dosje të vetme.

Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton dhe njeh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore siç cekën, në mes tjerash, nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore që “ kanë prioritet mbi dispozitat e ligjit dhe aktet tjera të institucioneve publike”.

Neni vijues 31 përsëritë tekstin e nenit 6 të KEDNJ ku përmend një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të krijuar ligjërisht.

Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave tjera rregullohen me ligj (neni 103) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës parashihet si autoritet përgjegjës për zhvillimin e rregullave gjyqësore në pajtim me ligjin (neni 108).

## 3. Gjendja e tanishme

### EULEX Kosovë

Rr. Mbreteresha Teuta 21,  
Tauk Bahçe,  
Rruga për Gerni,  
Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +(381) 38 51 39 300  
Fax: +(381) 38 51 39 333  
www.eulex-kosovo.eu,  
info@eulex-kosovo.eu

Një raport prej para pak kohe nga Vlerësimi i Kolegëve Misioni i Sundimit të Ligjit Gjyqësori<sup>1</sup> e njuh faktin që në Kosovë “edhe caktimi i lëndëve mbetet një problem. Shpesh është vetëm një numër shumë i vogël i prokurorëve publik ose gjykatësve që punojnë në zyre ose në gjykatë. **Prandaj i mbetet kryeprokurorit dhe kryetarit të gjykatës që të vendosin mbi caktimin e lëndëve, pa kurrfarë rregulla**”.

Kjo mund të rezultojë në shkeljen e së drejtës për gjykatës natyral ligjor siç parashihet me Nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.

“Plani Strategjik për Sistem Gjyqësor<sup>2</sup> transparent dhe të pakorruptuar cekë “menaxhimin e parregullt nga ana e epiorëve (afatet kohore, caktimi i orareve për lëndët)” dhe “përgjegjësinë e kryetarëve për shpërndarje dhe caktim të afateve kohore të lëndëve për gjykatësit” si dy “pengesa të sistemit gjyqësor në luftimin e korrupsionit”.

Me fjalë tjera, duket se është i nevojshëm miratimi i rregulloreve (ligje ose urdhëresa) të cilat do të vendosin paraprakisht dhe mbi elemente objektive një sistem për caktimin e dosjeve për gjykatësit ose kolegjet e gjykatave.

Një sistem transparent, nëpërmes së cilit mund të vëzhgohet dhe kontrollohet, nga ana e të gjithëve, kryerja e paanshme e funksioneve gjyqësore nga ana e “gjykatësit natyral ligjor”

Ky sistem duhet të jetë i përgjithshëm për të gjitha gjykatat e Kosovës dhe prandaj duhet të themelohet me ligje dhe urdhëresa të furnizuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Përgjithshmëria, objektiviteti, publiciteti i këtyre rregullave do të ndihmojnë në ngritjen e pakorruptueshmërisë së gjykatësve dhe do të ngritë besimin e publikut në Gjyqësorin.

Në anën tjetër këto masa, dhe veçanërisht kolegjet e krijuara paraprakisht dhe me përbërje të caktuar, do të ndihmojnë jurisprudencën e Gjykatës Supreme dhe atë të Gjykatave të Qarkut dhe atyre Komunale në interpretimin e ligjit në fuqi dhe do të zvogëlojnë numrin e ankesave të pabaza ose të papranueshme.

#### 4. Rekomandimet

Një propozim që ka të bëjë me sistemin për caktimin e lëndëve për gjykatat kosovare duhet të merr parasysh ndërlikueshmërinë e sistemit gjyqësor në këtë shtet dhe detyrat që ky duhet përmbushur në çështje civile dhe në ato penale.

#### EULEX Kosovë

Rr. Mbreterësha Teuta 21,  
Tauk Bahçe,  
Rruga për Germi,  
Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +(381) 38 51 39 300  
Fax: +(381) 38 51 39 333  
www.eulex-kosovo.eu,  
info@eulex-kosovo.eu

<sup>1</sup> Fokus në Prokuroritë Publike dhe Sistemin e Gjykatave në Rajonet e Pejës dhe Prizrenit, 19-23 Maj 2008, ekspertja Stephanie Sauer, Prokurore Publike nga Gjermania.

<sup>2</sup> “Plani Strategjik për një sistem gjyqësor transparent dhe të pakorruptuar” lëshuar në tetor 2007 nga ana e Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës



Gjyqësori i Kosovës përbëhet nga lloje të ndryshme të gjykatave me kompetenca në shkallën e parë dhe të dytë dhe me gjykatës vendimmarrës.

Gjykata Supreme e ka selinë në kryeqytet; gjykatat tjera janë të shpërndara në rajone.

Të gjitha gjykatat kanë nevojë për një diagram të organizimit të brendshëm për të garantuar respektimin e principeve të transparencës dhe objektivitetit në caktimin e gjykatësit të procedurës për secilën lëndë.

Synimet e diagrameve organizative janë arsyetimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efektshmërisë së shërbimeve gjyqësore.

1. Prandaj, secila gjykatë duhet të planifikojë periodikisht organizimin e saj të përgjithshëm dhe të veçantë; kjo duhet të ndodh një herë në vit ose një herë çdo dy vite. Diagrami organizativ duhet marrë parasysh në një rën anë kualitetin dhe kuantitetin e lëndëve potenciale dhe në anën tjetër numrin dhe specializimin e gjykatësve.

Aspekti i parë zakonisht përfaqësohet nga ngarkesa e punës në vitet e kaluara, këtu natyrisht mund të ketë përjashtime në raste të ngjarjeve ose situatave të veçanta, që do të mundësonin parashikimin e një ndikimi të shumëllojshëm të lëndëve të reja, ose kur gjykata ka një numër të pandryshuar (konsistent) të lëndëve të pakryera të shkaktuara nga rrethana të jashtëzakonshme të cilat janë verifikuar në të kaluarën (p.sh. krimet e luftës për të cilat nuk është vendosur ende).

Eksperiencia nga shtetet tjera sugjeron ose: 1) që të përcaktohen dy ose tre gjykatës (njëri prej tyre duhet të jetë nga gjykata e qarkut, të tjerët nga gjykata të ndryshme komunale) për secilën gjykatë të qarkut, të cilët janë të ngarkuar me detyrën e monitorimit të ngarkesës së punës së gjykatave të qarkut dhe atyre komunale dhe me detyrën e këshillimit të menaxhmentit të gjykatave mbi çështjen e organizimit të brendshëm, ose 2) të përdoren instrumente që tashmë ekzistojnë në Kosovë siç është "Ekipi për Përmirësimin e Gjykatave" i siguar nga Plani i Veprimit të Programit të Gjykatave Modele i një Organizate tjetër (USAID).

Në bazë të kësaj analize kryetari i secilës gjykatë do të përgatis planin e tij të organizimit, pas konsultimit me gjykatësit e interesuar.

2. Ndarja kryesore natyrisht është në mes të gjykatësve civil dhe atyre penal, ngarkesa e konsiderueshme e sistemit gjyqësor të Kosovës sugjeron ndarjen e barabartë, në sektorë civil dhe penal, të gjykatësve të caktuar në secilën gjykatë.

Gjykatësit penal marrin pjesë në gjykime ose janë gjykatës të procedurës paraprake.

Në çështjet civile dhe në ato penale gjykatësit që marrin pjesë në gjykime punojnë në kolegje ose vetëm, dhe diagrami organizativ cekë

#### EULEX Kosovë

Rr. Mbreteresha Teuta 21,  
Tauk Bahqe,  
Rruga për Germi,  
Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +(381) 38 51 39 300  
Fax: +(381) 38 51 39 333  
www.eulex-kosovo.eu,  
info@eulex-kosovo.eu

emrat e gjykatësve që përbëjnë një sektor dhe secilin kolegji dhe ditët e javës kur kolegjet ose gjykatësit që punojnë vetëm marrin pjesë edhe në seanca dëgjimore.

Gjithashtu janë paraparë edhe çështjet e veçanta që bien nën kompetencë të secilit gjykatës dhe kolegji dhe kriteret për shpërndarjen e lëndëve gjykatësve të kolegjit.

3. Shpërndarja në mes të kolegjeve dhe gjykatësve të vetëm duhet përcjellë kritere automatike dhe objektive, për shembull numrin e lëndëve ose shkronjën e parë të mbiemrit të pandehurit të parë. Përcaktimi i përbërjes dhe i kompetencës të sektorëve dhe gjykatësve të vetëm është vendimtar në respektim të principit të gjykatësit të duhur ligjor.
4. Diagramet organizative duhet të parashikojnë zëvendësimin e gjykatësve për shkaqe natyrale ose procedurale dhe gjithashtu duhet parashikuar mundësinë e thirrjes së gjykatësve që zakonisht marrin pjesë në gjykime civile për zëvendësime në raste të domosdoshmërisë. Një sugjerim për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është që të mundësojë, nëpërmes një urdhërese të veçantë, zëvendësimin e gjykatësve në mes të gjykatave të ndryshme. Mundësia e parë mund të parashikon zëvendësimin e gjykatësve prej dhe në gjykata të qarkut dhe komunale të një rajoni. Një mundësi më radikale mund të parashikojë zëvendësimin e gjykatësve në mes të gjykatave të rajoneve të ndryshme. Mekanizmi i zëvendësimit duhet të vendoset në nivele të ndryshme. Pra, për shembull, kryetari vendos për zëvendësime brenda gjykatës së njëjtë dhe duhet (vetëm) të informojë Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përderisa zëvendësimet në mes të gjykatave të ndryshme duhet të vendosen nga kryetari i gjykatës së lartë të interesuar dhe të aprovohen nga KGJK për shkak të lëvizjes së gjykatësve nga gjykatat dhe territoret ku mbajnë postin e tyre.
5. Gjatë hartimit ose gjatë aplikimit të tij ka hapësirë për gjykatësit që të shprehin nevojat dhe propozimet e tyre dhe eventualisht të kundërshtojnë diagramin organizativ.
6. Ky dokument, i hartuar nga kryetari i gjykatës, duhet të aprovohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. KGJK duhet të lëshojë, në intervale të caktuara kohore, udhëzime të përgjithshme mbi hartimin e diagrameve organizative për gjykatat dhe duhet ti drejtojë secilës gjykatë këshilla specifike, kurdo që kjo të vlerësohet si e nevojshme.

EULEX Kosovë

7. Për shkak të rëndësisë së funksionimit të mbarë të gjykatës për komunitetin vendorë dhe me qëllim të ngritjes së besimit publik në gjyqësorin, përfaqësuesit e avokatëve, të universiteteve dhe të komunitetit vendorë duhet të kenë të drejtë që të thonë fjalën e tyre në organizimin e gjykatave.

Hartimet e diagrameve organizative prandaj duhet të ju dërgohen këtyre palëve, të cilat do të kenë mundësinë që ti drejtojnë vërejtjet e tyre gjykatës së interesuar dhe KGJK-së.

Gjatë aprovimit të diagrameve organizative KGJK-ja duhet të merr parasysh vërejtjet e këtyre palëve.

8. Pasi që të aprovet nga KGJK-ja, Diagrami Organizativ i Gjykatës duhet të bëhet publik nëpërmes sistemeve adekuate.

Duhet cekur rëndësinë thelbësore të njohurisë publike të kriterëve të caktimit të lëndëve dhe të caktimit të gjykimeve.

I lartpërmenduri "Plan Strategjik për një Sistem Gjyqësor transparent dhe të pakorruptuar" sjell ndër mend faktin që mungesa e diturisë së qytetarëve për të drejtat e tyre stimulon korrupsionin.

Prandaj Diagrami Organizativ i Gjykatës duhet të botohet çdo vit në Gazetën Zyrtare, duhet të vendoset në Tabelën Zyrtare (Albo Pretorio) në korridor të gjykatës dhe gjithashtu duhet të ofrohen informata nëpërmes medieve dhe internetit.

9. Përfundim

Zhvillimi dhe implementimi i rregullave të përgjithshme dhe objektive në lidhje me caktimin e lëndëve dhe sigurimi i publicitetit adekuat kanë rëndësi kyçe në përmirësimin e gjyqësorit dhe në parandalimin e korrupsionit.

Këto aktivitete rrisin funksionalitetin e sistemit dhe janë në gjendje të rrisin besimin e qytetarëve.

Për arsyet e lartpërmendura, Asambleja e Gjykatësve të EULEX-it

## KËSHILLON

Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të adoptojë dhe të zbatojë një sistem të drejtë dhe transparent të caktimit të lëndëve në të gjitha Gjykatat e Kosovës.

### EULEX Kosovë